



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



**KOMUNA E SUHAREKËS**  
OPSTINE SUVA REKA  
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE"  
SH.A. SUHAREKË

**RREGULLORJA  
PËR  
PËRGJEGJËSIN E TË PUNËSUARVE NË "STACIONI I AUTOBUSAVE" SH.A  
SUHAREKË**

**Suharekë, me datë: 20.06.2014**

Në bazë të dispozitave të nenit 86,të Ligjit Nr-03/212(“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”,Nr-90/2010),të dispozitave të nenit 20,të Ligjit Nr-04/L-111,për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087,për ndërmarrjen publike(“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”,Nr-13/2012),Bordi i Drejtorëve i ndërmarrjes publike lokale ” Stacioni i Autobusave”SH.A në Suharekë , më \_\_\_\_\_ miraton këtë :

**RREGULLOREN  
PËR  
PËRGJEGJËSIN E TË PUNËSUARVE NË”STACIONI I AUTOBUSAVE”SH.A  
SUHAREKË**

**I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1.**

Me dispozitat e kësaj Rregulloreje përcaktohet:procedurat unike disiplinore klasifikimi i shkeljeve të punës nga të punësuarit në ” Stacioni i Autobusave”SH.A, me seli në Suharekë (në tekstin e mëtejme :Ndërmarrja),paraqitja-identifikimi i shkeljesë së procedurës disiplinore ,shkeljet disiplinore,emërimi i komisionit disiplinor,mbështetja e komisionit disiplinor,masat në lidhje me shkeljet disiplinore dhe qështjet e tjera,procedurat e ankesave,e drejta për ankesë,emërimi i komisionit për ankesa.

**Neni 2.**

**Paraqitja dhe identifikimi i shkeljes disiplinore:**

Gjdo shkelje e dyshua nga zyrtarët e ndërmarrjes publike lokale,duhet të paraqitet te udhëheqësi i drejtëpërdrejt ose te udhëheqësi më i lartë i ndërmarrjes publike lokale,paraqitja mund të bëhet gojarisht ose me shkrim nga zyrtarët e ndërmarrjes publike lokale ,ose nga pjestarët e publikut.

**Neni 3.**

Kryeshefi ekzekutiv menjëherë pas pranimit të raportit me shkrim ose raportimit me gojë për shkelje të supozuar disiplinore ,duhet të hetojë rastin,të intervistoj shkelsin e supozuar , personin qe ka raportuar rastin dhe gjdo njërin që mund të ofrojë dëshmi lidhur me rastin,të analizoj deetajet e dhëna në deklarata,dhe sipas vlerësimit të tij do të vendosë se a do të jetë shkelje e natyrës parëndësishme shkelje e lehtë apo e rëndë-serioze.Në marrjen e vendimit,udhëheqësi i njesis përkatëse,do të mbështetet në dispozitat e kësaj Rregulloreje.

#### **Neni 4.**

##### **Shkeljet disiplinore**

##### **Shkeljet e lehtë disiplinore konsiderohet:**

- 1) Mungesa e paarsyeshme nga puna.
- 2) Mos mbajtja e karteles identifikuese.
- 3) Mosrespektimi i normave për veshje dhe paraqitje në punë.
- 4) Mosmbajtja në mënyrë të rregullt e të dhënave dhe shkresave zyrtare që ndërlidhen me detyrat e punës.
- 5) Mosrespektimi i orarit të punës.
- 6) Mosinformimi për mungesen nga puna dhe dy mungesa të paarsyeshme me kohezgjatje një ditore brenda vitit kalendarik dhe
- 7) Gabimet e vogla të pakujdesshme ose gabimet e përsëritura që nuk do të jenë temë që formojnë procedurat disiplinore ,do të merren si shkelje e lehtë disiplinore.

2.Udhëheqësi i organit përkatës do të mbledhë dhe rishqyrtojë qdo dokument ose evidencë që ka lidhje me rastin,do të marrë në pyetje shkelësin e supozuar,deklaratën e tij,personin që ka paraqitur rasti e supozuar dhe secilin që e ka informata në lidhje me rastin.

3.Intervistimi duhet të mbahet sa me shpejt që është e mundur,brenda 3 ditëve të punës pas paraqitjes së rastit me qellim të përcaktimit se a është bërë shkelje e lehtë apo aty ka dëshmi se është kryer shkelje e rëndë.Shkelësi i supozuar mund të shoqërohet nga një punonjës tjetër sipas zgjedhjes së tij,i cili nuk mund të përgjigjet në emër të tij.

#### **Neni 5.**

Nëse udhëheqësi i njësisë përkatëse konkludon se është shkelje e lehtë dhe është hera e parë,është i përshtatshëm një paralajmërim verbal,kurse për shkelje të përsëritura është i përshtatshëm një paralajmërim me shkrim dhe atë jo më larg se 3 ditë pune pas intervistës.Procesverbali i paralajmërimit me gojë dhe me shkrim mund të vendoset në dosjen personale të personit.

#### **Neni 6 .**

##### **Përcaktimi i shkeljes së rëndë disiplinore:**

1.Nëse udhëheqësi konkludon se është kryer shkelje e rëndë ai do të paraqes rastin te komisioni disiplinor i organit përkatës të Ndërmarrjes publike lokale.

2.Udhëheqësi i organit përkatës do të intervistojë shkelësin e supozuar brenda 3 ditësh prej që është referuar te komisioni disiplinor dhe do të sqarohet.

- natyra e shkeljes së supozuar,
- që shkelja e supozuar të trajtohet si serioze dhe është referuar te komisioni disiplinor,
- ku dhe kur do të mbahet seanca e komisionit disiplinor dhe
- që ai mund të shoqërohet në seancë nga v një i punësuar tjetër.

## **Neni 7.**

Kur ka evidenca të dhunës ndaj njerëzve të tjerë ose rrezikut ndaj pronës ,Kryeshefi Ekzekutiv mund të vendos të suspendojë nga puna dhe atë me pagesë për kohën derisa hetimet dhe procedurat disiplinore të jenë duke u zhvilluar.

## **Neni 8.**

### **Si shkelje diciplinore e rëndë konsiderohet:**

- 1) Kundërshtimi i parsyshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara në kontratën e punës dhe aktin e brendshëm të ndërmarrjes;
- 2) Vjedhja,mashtrimi,falsifikimi i dokumenteve ,dëmtimi ose shfrytëzimi i pautorizuar i pasurisë së ndërmarrjes publike lokale;
- 3) Prishja e kodit të mirësjelljes në ndërmarrjen publike lokale;
- 4) Mungesa e parsyeshme në punë më shumë se 3 ditëradhazi pa asnjë arsyeje dhe pa e lajmëruar mungesën;
- 5) Gabimet e perseritura të cilat në shpeshtësinë dhe peshën e tyre e qrrregullojn ecurinë normale të punës;
- 6) Diskriminimi ose keqtrajtimi i drejtpërdrejt ose jo i drejtpërdrejt ,kundër personit tjetër të ndërmarrjes ,në bazë të gjinisë,racës,ngjyrës,gjuhës,regjionit,banimit,mendimeve politike ,origjinës sociale,dhe rasteve tjera të mbrojtura me ligj;
- 7) Keqtrajtimi seksual i personit tjetër,i karakterizuar si qfarëdo sjellje fizike apo verbale e natyrës seksuale,shkelja e dinjitetit të personit në punë që është e padëshirueshme ose fyese e cila krijon armiqësi ,duke kërcenuar ose frikësuar atë person,
- 8) Sjellja e keqe në vendin e punës që nuk përkon me statusin e të emruarit ,dhe e cila mund të sjellë ndërmarrjen në diskreditim,do t'i sjell ndërmarrjes emër të keq;
- 9) Dëmtimi i pronës me paramendim.
- 10) Zbulimi i fshehtësisë afariste.
- 11) Paaftësia serioze gjstë punës e shkaktuar nga alkooli ose droga.
- 12) Dhënia e deklaratës së rrejshme në lidhje me konfliktin e interesit.
- 13) Në qoftë qoftë se brenda një periudhe prej 1,(një) viti i shqiptohet 3(tri) vërejtje me shkrim nga udhëheqësi i drejtpërdrejt.
- 14) Sjellje agresive ,kërcënuese ose fyese në vendin e punës ,dhe shkelje të ngjajshme të parapara me Ligj dhe aktet tjera të ndërmarrjes publike lokale.

## Neni 9.

### **Komisioni disiplinor**

1. Kryeshefi ekzekutiv do të formojë një Komision disiplinor i cili do të vendos në rastet që kanë të bëjnë me shkeljet serioze të supozuara. Komisioni do të përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të përhershëm nga radha e zyrtarve të ndërmarrjes.
2. Mandati i antarëve të komisionit disiplinor do të zgjas, aq sa zgjatë edhe mandati i Kryeshefit Ekzekutiv i cili ka emëruar këtë komision.
3. Në rastet e konfliktit të interesit ku objektiviteti i anëtarit doë vërehet në dyshim, antari i komisionit do të zëvendësohet për atë seancë të veçantë dhe atë në rastet:

a) kur antari i komisionit është në pozitë të udhëheqësit ndaj shkelësit të supozuara dhe ka lidhje në shkelësin nga ana familjare në shkallën e katërt në vijë të tërthort.

b) kur antari i komisionit ka qenë viktimë e shkelësit të supozuar ose ka lidhje me viktimën nga ana familjare deri në shkallën e katërt në vijë të tërthort.

## Neni 10.

### **4. Mbështetje e komisionit disiplinor**

Shërbimi profesional i ndërmarrjes publike lokale "Stacioni i Autobusave" SH.A në Suharekë, komisioni disiplinor do të ofroj këto të dhëna:

- sigurimin e këshillave dhe udhëzimeve për antarët e komisionit;
- grumbullimin e dëshmimeve të dokumentuara;
- përgaditja e orarit të seancave;
- njoftimin e personave që kërkohen të jenë prezent për detajet e vend takimit, datën dhe kohën e seancës;
- mbajtjen e procesverbalit për seancën disiplinore dhe vendosja e tij në dosjen e kandidatit, dhe qështjet tjera që kërkohen për zhvillimin e procedurës disiplinore;

## Neni 11.

1. Seanca disiplinore duhet të mbahe sa më shpejt që është e mundur, dhe në gjdo rast jo më vonë se 15 ditë, kurse vendimi duhet të merret brenda 30 ditëve, prej ditës së lajmërimit të rastit.

### **Komisioni disiplinor ka këto kompetenca:**

- a) do të dëgjojë dëshmitë lidhur me shkeljet e supozuar;
- b) do vendosë, në bazë provave, nëse është kryer shkelja e supozuar dhe
- c) do të përcaktojë masën disiplinore që duhet t'i shqiptohet.

3.Qëllimi i seancës është të vërtetojë faktet.

4.Vendimi i organit përkatës duhet t'i kontribuoj shkelësit brenda 5 ditësh nga data e marrja së vendimit.Procesverbal dhe Vendim i organit përkatës të vendoset në dosjet e personit.

### **Neni 12**

#### **Masat për shkeljet e lehta disiplinore;**

1.Komisioni disiplinor pas shqyrtimit të hollësishme të rastit i propozon Organit përkatëse që të aplikojë këto masa:

- a) paralajmrimi verbal (gojor)
- b) vërejtje me gojë
- c) vërejtje me shkrim
- d) ulja e pozitës,
- e) ndalimi i 1/3 të pagë për një periudhë deri në 3(tre) muaj
- f) suspendim i përkohshëm, për një periudhë 1 (një) deri në 6(gjashtë) muaj me pagesë,dhe
- g) ndërprerja e marëdhënies së punës,

2.Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1,pika (a),(b) dhe (c) të këtij neni do të shqiptohen nga ana e Kryeshefit ekzekutiv,prë shkelje e lehta ,ndërsa masat disiplinore nga pika (d).(e),(f).dhe(g) të këtij neni shqiptohet nga Komisioni disiplinor.

## **III.PROCEDURA E ANKESAVE**

### **Neni 13**

Procedura e ankesave ka për qëllim të mbrojë të punsuarit nag vendimet e padrejta.Personi i pakënaqur me vendimin me të cilin është shqiptuar masa disiplinore ka të drejtë ankese.Ankesa i drejtohet organi të shkallës së dytë:

#### **Emërimi i komisionit të ankesave;**

### **Neni 14.**

1. kryeshefi ekzekutiv do të emrojë një komision të ankesave.
2. Komisioni do të përbehet nga 3(tre)antarë të përhershëm nga radha e zyrtarëve të ndërmarrjes.
3. mandati i antarëve të komisionit për ankesa do të zgjasë,aq sa zgjatë edhe mandati i Kryeshefit ekzekutiv i cili ka emëruar këtë komision.
4. antarët e komisionit të ankesave nuk mund të jenë edhe antarë të komisionit disiplinor të shkallës së parë.

### **Neni 15.**

Në rast të konfliktit të interesit anëtari i komisionit të ankesave tërhiqet dhe zëvendësohet për seancë të veqntë,nëse:

- a) është në raport menaxhimi drejtues me ankuesin,ose është i afër me atë nga ana familjare deri në shkallë të katërt në vijë të tërthort;
- b) është i implikuar në incident (ngjarje) që është temë e ankesës.

### **Neni 16.**

Shërbimi profesional i ndërmarrjes do t'i ofrojë komisionit të ankesave :

- a) këshilla,udhëzime,grumbullimin e dëshmimeve dokumentuese dhe shpërndarjen e dokumenteve te duhura të gjitha palëve;
- b) përgaditja e prarit të seancave shqyrtuese dhe
- c) mbajtaj e procesverbalit të seancave dhe vendosjen e tij në dosjen personale disiplinore.

### **Neni 17.**

**1.**Paraqitësi i ankesës duhet të paraqet fakte,argumente dhe prova të reja duke përmbledhur shkurtimisht arsyjet për ankesën.

**2.**Seanca për shqyrtimit e ankesave duhet të mbahet sa më shpejt që është e mundur dhe për qdo rast jo më vonë se 15 ditë,nga dita kur ankesa i është drejtuar komisionit të ankesave.

**3.**Komisioni i ankesave do të ketë këto kompetenca:

- a) lënia në fuqi të aktit dhe rrëzimin e ankimit;
- b) shfuqizimin /revokimin e aktit dhe pranimin e ankimit;
- c) ndryshimin e aktit administrativ duke pranuar pjesërisht ankimin;
- d) detyrimin e orgnit administrativ kompetent për të nxjerr aktin administrativ kur është refuzuar pa të drejtë nxjerrja e tij.

### **Neni 18.**

**1.**Seanca dëgjimore duhet të kompletohet sa më shpejtë që mundet dhe komisioni duhet të vendos brenda 30 ditëve orej ditës kur ankesa i është paraqitur komisionit;

**2.**komisioni vendos me shumicë e votova të antarëve;

**3.**komisioni merr vendim i cili komunikohet ankuesit brenda 5(pesë) ditëve nga dita e marrjes;

**4.**vendimi së bashku me procesverbalin e komisionit të ankesave duhet të vendoset në dosjen e ankuesit.

#### **IV.DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE TË HYRJES NË FUQI**

##### **Neni 19.**

1.Në rast konflikti mes dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe Ligjeve që e rregullojnë qështjen e punësimit dhe masave disiplinore,do të mbizotërojë-aplikohet dispozitat e Ligjeve dhe akteve nënë ligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës,që e rregullojnë këtë qështje.

2.Interpretimin autentik të kësaj Rregulloreje e bënë Bordi i Drejtorëve.

##### **Neni 20.**

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdest Kryeshefi ekzekutiv,Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusave" në Suharekë, SH.A,në Suharekë.

##### **Neni 21.**

Kjo rregullore mundë të ndryshohet me procedurë të njejtë me atë të miratimit nga Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale"Stacioni i Autobusave" në Suharekë, me propozimet e arsyetuara me shkrim.

##### **Neni 22.**

Kjo rregullore hyn ne fuqi 8,(tetë) ditë pas miratimit nga Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusave" SH.A në Suharekë, dhe pas shpalljesë publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Ndërmarrjes Publike Lokale Sacioni i Autobusave"SH.A në Suharekë.

#### **BORDI I DREJTORËVE**

#### **KRYESUESI I BORDIT TË DREJTORËVE**

Nr. \_\_\_\_\_  
Me datë 20.06.2014

---

**Xhelal Çelaj**